



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 3166 prot.

Himarë, më 12.06.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË HIMARËS DHE GJITHË PALËVE TË INTERESUARA

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" në nenin 9 pika 1, 3, të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18, si dhe në Rregulloren e Këshillit bashkiak "Për konsultimet publike",

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike në kuadër të:

- **HARTIMIT TË RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETEJEVE VOLUMINOZE NË BASHKINË HIMARË**

Ftojme të gjithë grupet e interesit si qytetarë, biznese, grupe të marginalizuara, të rinj/të reja, shoqëri civile, të bëhen pjesë e këtyre dëgjesave për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet ditën e Enjte më datë **20.06.2024 ora 11:00**, Salla **" Neço Muko "** Himarë

- Këto takime kanë si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve të cilat do të shërbejnë për orientim në hartimin e Rregullores për menaxhimin e mbetjeve voluminoze në bashkinë Himarë

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të e-mailit:

- Koordinatori për të drejtën e informimit: erindhabili@himara.gov.al
- Adresa zyrtare e bashkisë Himarë: info@himara.gov.al

Këto dëgjesa publike do të zhvillohen në bashkëpunim me bashkinë Himarë dhe anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme.

KRYETAR I BASHKISË

Arqileo Bolland

